



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



**Datë:14/05/2024**

Njësia përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në Komisionin e Pavarur të Mediave në bazë të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 48, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.3, si dhe nenit 3, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe paragrafin 3, të Rregullores Nr.04/2023 për Pranimin, Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Kryeshefit Ekzekutiv të Zyrës Ekzekutive të KPM-së, me datë 14.05.2024 publikon këtë:

### **SHPALLJE PUBLIKE**

***Për pranimin e aplikimeve për një (1) ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese***

**Kandidati për ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese, në pajtim me nenin 3, paragrafin 3, të Rregullores Nr.04/2023, për Pranimin, Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Kryeshefit Ekzekutiv të Zyrës Ekzekutive të KPM-së, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:**

1. Të ketë diplomë universitare, kurse për diplomat e marra jashtë vendit nevojitet nostrifikimi;
2. Të ketë përvojë profesionale në organizatat të cilat mbikëqyrin procesin e përzgjedhjes për pozitat e nivelit drejtues ose në menaxhimin e burimeve njerëzore;
3. Të mos ketë qenë anëtar i ndonjë partie politike në katër (4) vitet e fundit;
4. Të ketë integritet moral dhe profesional;
5. Të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
6. Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi

**Kandidati për ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese, duhet të dorëzojë dokumentet në vijim:**

- Biografinë (CV-në)
- Kopjen e diplomës universitare të vlefshme në Kosovë e vërtetuar nga noteri, ndërsa për rastet e diplomave nga shtetet tjera, diplomat duhet të jenë të nostrifikuara.
- Dëshminë mbi përvojën e punës nga institucioni punëdhënës (Dëshmia mbi përvojës e punës duhet të përcaktoj pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë)
- Deklaratën nën betim të shkarkuar nga faqja zyrtare e KPM-së që dëshmon mos ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në kriteret 3 dhe 6 të kësaj shpalljeje publike.

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Kopjen e letërnjoftimit (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidati për ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimin për Kategorinë e Lartë Drejtuese do të ketë mandat vetëm për një (1) procedurë të rekrutimit dhe përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për procedurë të rekrutimit, në pajtim me nenin 4, të Rregullores Nr.04/2023 për Pranimin, Emërimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Kryeshefit Ekzekutiv të Zyrës Ekzekutive të KPM-së.

**Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse është i hapur nga data 14/05/2024 deri më datë 21/05/2024.**

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim për *ekspert të jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimin për Kategorinë e Lartë Drejtuese* dokumentet mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: [nalan.abazgjik@kpm-ks.org](mailto:nalan.abazgjik@kpm-ks.org).

Dokumentet e pa kompletuara dhe te arritura pas afatit nuk do të merren për shqyrtim. Kandidatet duhet t'i ofrojnë të dhënat e sakta mbi adresën dhe numrin e telefonit kontaktues.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në nr. e tlf. 038-245-031 apo në e-mail adresën: [nalan.abazgjik@kpm-ks.org](mailto:nalan.abazgjik@kpm-ks.org)

Ju faleminderit!